

Njoftim për Vendimin e Rishqyrtimit të Çmimeve

Bordi i ZRRE-së në seancën e vet të mbajtur më datën 7 maj 2007, ka vendosur të rishqyrtojë Vendimin D_29_2006 të datës 21 dhjetor 2006 mbi “Të hyrat e lejuara për KEK Sh.A. dhe KOSTT Sh.A. lidhur me periudhën e shqyrtimit të çmimeve 2007-2009”, si dhe të rishqyrtojë Vendimin Nr. D_39_2007 të datës 15 mars 2007 mbi “Tarifat e propozuara me pakicë për KEK Sh.A dhe tarifat e transmisionit për KOSTT Sh.A.”, duke pasur parasysh të dhënat e reja teknike dhe ekonomike të dorëzuara nga KEK Sh.A më datën 25 prill, dhe KOSTT Sh.A me datën 2 dhe 4 maj 2007. Vendimi është i publikuar në faqen elektronike të ZRRE-së www.ero-ks.org.

Bordi i ZRRE-së i fton të dyja palët, KEK Sh.A dhe KOSTT Sh.A, që të propozojnë dhe dorëzojnë tarifat e azhurnuara me pakicë dhe ato të transmisionit, për shqyrtim nga Boardi i ZRRE-së, si pjesë e procesit të rishqyrtimit.

Çdo palë që dëshiron të paraqesë komente lidhur me këtë Vendim dhe rishqyrtimin e çmimeve, ftohet që t'i dërgojë ato, jo më vonë se me 10 maj 2007, me e-mail në këtë adresë: ERO.PRICING-TARIFFS@eumik.org, apo me faks: (+381 38 247 620), apo me letër: (Rr. Hamdi Mramori No. 1 10000 Prishtinë) të shenjuar, për Vëmendjen e Departamentit të Tarifave dhe Çmimeve.